# DËSHMI ARKIVI

**A-462576**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vlora Hyseni dorëzohet në Kosovë - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/vlora-hyseni-dorezohet-ne-kosove/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:49:03 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 18:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8fcc85b79c8c52c743458e5eb4b2481c82aeb251f95795e98ae495ea960be62b` |
| TEKSTI | `935e62f42675c66e6024c3d16d61160d3edacd2e55af2165c6db2f0b5b405678` |
| PAMJA | `aa622ea473146392678d4eb76ab91f9581c6d2ad5e3f68aa375ffb75fdf0ff75` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ef271e32b7dadd83ca742ebdb7097e690172fa138d2e63d1c0597104a43e4672` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ef271e32b7dadd83ca742ebdb7097e690172fa138d2e63d1c0597104a43e4672`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

# Vlora Hyseni dorëzohet në Kosovë

22 Shtator 2026 | 20:00

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Ish-kreu i SHISH Vlora Hyseni është vetëdorëzuar në kufirin e Kosovës. Mediat e Kosovës sapo kanë njoftuar ndalimin e saj teksa kthehej nga një udhëtim në Baku.

Hyseni ndodhej jashtë vendit në momentin kur SPAK dhe GJKKO ndërmorën veprimet ndaj saj. Gjatë paradites u raportua se ajo ndodhej në Baku, ku kishte marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare me drejtues të shërbimeve informative. Për këtë arsye, masa e sigurisë nuk ishte ekzekutuar në momentet e para të operacionit.

Më herët, Gjykata e Posaçme, me kërkesë të SPAK, kishte caktuar ndaj Hysenit masën "arrest në shtëpi", ndërsa ajo u pezullua nga detyra si drejtuese e SHISH. Sipas SPAK, Hyseni është nën hetim për veprat penale "përkrahja e autorit të krimit" dhe "zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete".

Hetimi është pjesë e një fraksioni të dosjes që lidhet me biznesmenin Ergys Agasi. Sipas SPAK, hetimet janë zhvilluar në kuadër të procedimit penal nr. 20/1 të vitit 2025. Në të njëjtin operacion janë kryer kontrolle në disa ambiente dhe banesa, përfshirë banesën e ish-drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ilir Proda.

SPAK dyshon se Hyseni ka përkrahur autorin e krimit dhe ka nxjerrë të dhëna sekrete shtetërore. Sipas raportimeve, hetimet e reja ndaj saj janë zhvilluar pas administrimit të materialeve të sekuestruara gjatë hetimit të Ergys Agasit, përfshirë të dhëna nga pajisje elektronike dhe materiale të tjera të mbledhura nga prokurorët.

Hyseni nuk ka pasur urdhër-arrest në Kosovë dhe është dorëzuar tek autoritetet shqiptare në momentin e kalimit të kufirit në Vërmicë

Hyseni u emërua në krye të SHISH në vitin 2023, pasi më herët kishte shërbyer në strukturat e inteligjencës në Kosovë. Ajo ishte propozuar nga kryeministri Edi Rama për drejtimin e institucionit dhe më pas mori detyrën si drejtuese e Shërbimit Informativ të Shtetit.

**Shiko në:**

LAJMI I FUNDIT

20:28 **Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu**

20:16 **Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës**

20:11 **Trump zbulon marrëveshje aksionesh me vlerë miliona dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI**

20:05 **Shtetet Baltike i kërkojnë BE-së 500 milionë euro për mbrojtjen kundër dronëve**

19:51 **Moska refuzon armëpushimin, Lavrov: Rusia nuk do t'i ndalë luftimet**

19:37 **E ardhmja e Merz në pikëpyetje, gati gjysma e votuesve kërkojnë zgjedhje të reja**

TESTIM

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | EURONEWS ALBANIA | LAJM KRYESOR | VENDI

**Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu**

Është arrestuar në Rusi, me qëllim ekstradimi, Shpëtim Aliu, i njohur edhe me emrin Salvatore, i shpallur në kërkim nga SPAK si drejtues i një...

20:28 | 23/09/2026

AKTUALITET | VENDI

**Tatimet vijojnë rimbursimin e tatimit të mbipaguar, rreth 2200 përfitues**

Administrata Tatimore po vijon procesin e rimbursimit të tatimit të mbipaguar për individët në kuadër të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin...

18:12 | 23/09/2026

AKTUALITET | VENDI

**Dhunoi fizikisht dhe psikologjikisht një vajzë dhe vëllain e saj të mitur, ndalohet nga AMP polici në Klos**

Është ndaluar këtë të mërkurë nga AMP një punonjës policie në Klos, pasi akuzohet për veprën penale "Dhunë në familje". Sipas njoftimit të AMP-së, punonjësi...

17:46 | 23/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.